



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 125

Tiranë – E martë, 20 shtator 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 65/2022, datë 8.9.2022	Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore..... 16019
Vendim i Kuvendit nr. 66/2022, datë 8.9.2022	Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për hartimin e shtesave dhe ndryshimeve në ligjin nr. 15/2015, ‘Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian’”..... 16019
Vendim i Kuvendit nr. 67/2022, datë 8.9.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 69/2021, “Për caktimin e anëtarësisë së Komisioneve të Përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar..... 16020
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 167, datë 8.9.2022	Për delegim kompetence..... 16020
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 402, datë 15.9.2022	Për përditësimin e urdhrit të ministrit nr. 72, datë 2.3.2017, “Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve”, të ndryshuar..... 16021
Urdhër i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 540, datë 15.9.2022	Për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshti “Zubeyde Hanim”, Tiranë..... 16023
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 220, datë 1.9.2022	Mbi miratimin e ndryshimeve në rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike..... 16025
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 233, datë 12.9.2022	Mbi shqyrtimin e ankesës së konsumatorit A.Ç. ndaj Furnizuesit të Shërbimit Universal FSHU sh.a. dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a..... 16030
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 379, datë 31.8.2022	Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kurbin sh.a..... 16032

Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 380, datë 31.8.2022	Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 130, datë 11.11.2020, “Për licencimin e sh.a. Ujësjetllës-Kanalizime Vorë”.....	16033
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 381, datë 31.8.2022	Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjetllës-Kanalizime Bulqizë sh.a.....	16034
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 382, datë 31.8.2022	Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjetllës-Kanalizime Kukës sh.a.....	16038
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 383, datë 31.8.2022	Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë për shoqërinë Ujësjetllës-Kanalizime Konispol sh.a.....	16042
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Ferdinand Mihaj.....	16046



VENDIM
Nr. 65/2022

PËR ZGJATJEN E AFATIT TË
VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË
POSAÇËM PARLAMENTAR PËR
REALIZIMIN E REFORMËS
ZGJEDHORE

Në mbështetje të nenit 77, pika 1, të Kushtetutës dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e bashkëkryetarëve të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Afati i veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore zgjatet për një periudhë 6-mujore nga data e miratimit të këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 8.9.2022.

VENDIM
Nr. 66/2022

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË
POSAÇËM PARLAMENTAR “PËR
HARTIMIN E SHITESAVE DHE
NDRYSHIMEVE NË LIGJIN NR.
15/2015, ‘PËR ROLIN E KUVENDIT NË
PROCESIN E INTEGRIMIT TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
BASHKIMIN EVROPIAN”

Në mbështetje të neneve 77, pika 1, dhe 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 24 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për hartimin e shtesave dhe ndryshimeve në ligjin nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian””.

II. Komisioni ka objekt të veprimtarisë së tij hartimin e shtesave dhe ndryshimeve në ligjin nr. 15/2015, “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”.

III. Anëtarësia e Komisionit përbëhet nga përfaqësues të partive politike parlamentare, me përbërje të barabartë mes shumicës dhe pakicës.

IV. Komisioni drejtohet nga dy bashkëkryetarë, një nga Partia Socialiste dhe një nga Partia Demokratike.

V. Përbërja e Komisionit është, si më poshtë:

1. Taulant Balla	bashkëkryetar	(PS)
2. Jorida Tabaku	bashkëkryetare	(PD)
3. Etilda Gjonaj	anëtare	(PS)
4. Toni Gogu	anëtar	(PS)
5. Gerta Duraku	anëtare	(PS)
6. Kreshnik Çollaku	anëtar	(PD)
7. Mesila Doda	anëtare	(Demokraci dhe Integrim)
8. Fatmir Mediu	anëtar	(Aleanca për Ndryshim)

VI. Çdo parti që përfaqësohet në komision ka të drejtë të propozojë amendamente për diskutim dhe miratim. Palët duhet të angazhohen dhe të gjejnë konsensusin në lidhje me to.

VII. Mbledhjet e Komisionit janë të vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Komisionit. Vendimmarrja e Komisionit synon konsensusin e gjerë për të gjitha propozimet. Vendimet e Komisionit konsiderohen të miratuara me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve, por vetëm kur kanë marrë njëkohësisht konsensusin e të dy bashkëkryetarëve.

VIII. Komisioni e ushtron veprimtarinë për një afat 2-mujor nga data e miratimit të këtij vendimi. Në rast nevojë, me kërkesë të arsyetuar të bashkëkryetarëve, Kuvendi vendos zgjatjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së Komisionit me një vendim të veçantë të Kuvendit.



IX. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për krijimin e kushteve të punës, si dhe për mbështetjen me burime njerëzore, financiare dhe logjistike të veprimtarisë së Komisionit dhe të grupit të ekspertëve të ngritur pranë tij.

X. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 8.9.2022.

VENDIM
Nr. 67/2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 69/2021, “PËR CAKTIMIN
E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË
PËRHERSHME TË KUVENDIT”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 21 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën I të vendimit nr. 69/2021, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

“Deputeti Arben Ahmetaj caktohet anëtar në Komisionin për Integrimin Evropian.”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 8.9.2022.

URDHËR
Nr. 167, datë 8.9.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000/2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të VKM-së nr. 111, datë 2.3.2022, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, të ndryshuar; si dhe të VKM-së nr. 822, datë 7.10.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, zëvendësministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë z. Ilir Bejtja, për miratimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, të cilat nuk janë objekt koncesioni, sipas vendimit nr. 822, datë 7.10.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar.

2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga z. Ilir Bejtja, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, duke filluar nga data 1.9.2022.

3. Ngarkohet zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë z. Ilir Bejtja, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku



URDHËR

Nr. 402, datë 15.9.2022

**PËR PËRDITËSIMIN E URDHËRIT TË
MINISTRIT NR. 72, DATË 2.3.2017,
“PËR MIRATIMIN E LËNDËVE
VEPRUESE NË PËRMBAJTJE
TË PMB-ve”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 19, pika 5, të kreut V, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar; si dhe të pikës 6.3, të kreut VII, të vendimit nr. 335, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, dhe sipas propozimit të strukturës përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin e ministrit nr. 72, datë 2.3.2017, “Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të

PMB-ve”, të ndryshuar, bëhet përditësimi, me ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

a) Rinovohen regjistrimet për 3 (tri) lëndë vepruese, nga të cilat, 1 (një) lëndë vepruese me rrezik të ulët, bashkëlidhur këtij urdhri;

b) Zgjatën afatet e regjistrimit për 52 (pesëdhjetë e dy) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;

c) Hiqen 4 (katër) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;

ç) Zëvendësohen kushtet te kolona “Dispozitat specifike” për *Paraffin oils*, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ky përditësim të pasqyrohet në dokumentet e regjistrimit të PMB-ve, të regjistruara.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

1. RINOVohen REGJISTRIMET (RIREGJISTRIM) PËR LËNDËT VEPRUESE, SI MË POSHTË:

1.1 LËNDA VEPRUESE *Straight Chain Lepidopteran Pheromones (aldehydes dhe alcohols)*

Nr.	Emri i zakonshëm dhe nr. i identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Data e përfundimit	Dispozita specifike
1	<i>Straight Chain Lepidopteran Pheromones</i> (aldehydes)	Detajet janë dhënë në Raportin e Rishikimit SANTE/10828/2021	Detajet janë dhënë në Raportin e Rishikimit SANTE/10828/2021	1.9.2022	30.8.2037	Për zbatimin e parimeve uniforme, konkluzionet e raportit të rinovimit për <i>Straight Chain Lepidopteran Pheromones</i> të merren në konsideratë. T’i kushtohet vëmendje e veçantë efikasitetit të produkteve për mbrojtjen e bimëve që përmbajnë ose substanca të veçanta ose përzierje të tyre kur vlerësojnë aplikimet për regjistrim. Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, kur është e përshtatshme.
	<i>Straight Chain Lepidopteran Pheromones</i> (alcohols)	Detajet janë dhënë në Raportin e Rishikimit SANTE/10828/2021	Detajet janë dhënë në Raportin e Rishikimit SANTE/10828/2021	1.9.2022	30.8.2037	Për zbatimin e parimeve uniforme, konkluzionet e raportit të rinovimit për <i>Straight Chain Lepidopteran Pheromones</i> të merren në konsideratë. T’i kushtohet vëmendje e veçantë efikasitetit të produkteve për mbrojtjen e bimëve që përmbajnë ose substanca të veçanta ose



						përzierje të tyre kur vlerësojnë aplikimet për regjistrim. Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, kur është e përshtatshme.
--	--	--	--	--	--	---

1.2 LËNDA VEPRUESE ME RREZIK TË ULËT *Straight Chain Lepidopteran Pheromones (acetates)*

Nr.	Emri i zakonshëm dhe nr. identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Data e përfundimit	Dispozita specifike
1	<i>Straight Chain Lepidopteran Pheromones (acetates)</i>	Detajet janë dhënë në Raportin e Rishikimit SANTE/10828/2021	Detajet janë dhënë në Raportin e Rishikimit SANTE/10828/2021	1.9.2022	30.8.2037	Për zbatimin e parimeve uniforme, konkluzionet e raportit të rinovimit për <i>Straight Chain Lepidopteran Pheromones</i> , të merren në konsideratë. T'i kushtohet vëmendje e veçantë efikasitetit të produkteve për mbrojtjen e bimëve që përmbajnë ose substanca të veçanta ose përzierje të tyre kur vlerësojnë aplikimet për regjistrim. Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, kur është e përshtatshme.

2. ZGJATEN AFATET E REGJISTRIMIT PËR LËNDËT VEPRUESE, SI MË POSHTË:

- Deri më 31 korrik 2022:

1. Bispyribac

Gjithsej: 1 lëndë vepruese.

- Deri më 31 maj 2023:

1. Heptamaloxyloglucan

Gjithsej: 1 lëndë vepruese.

- Deri më 31 tetor 2023:

1. Deltamethrin

2. Flufenacet

3. Fosthiazate

4. Chlorotoluron

5. Daminozide

6. MCPA

7. MCPB

8. Prosulfocarb

9. Fludioxonil

10. Clomazone

11. Bensulfuron

12. Sodium 5-nitroguaiacolate

13. Sodium o-nitrophenolate

14. Sodium p-nitrophenolate

15. Tebufenpyrad

16. Prothioconazole

17. Aclonifen

18. Metazachlor

19. Proquinazid

Gjithsej: 19 lëndë vepruese.

- Deri më 30 nëntor 2023:

1. Tritosulfuron

2. Chlormequat

3. Propaquizafop

4. Quizalofop-P-ethyl

5. Quizalofop-P-tefuryl

Gjithsej: 5 lëndë vepruese.

- Deri më 11 dhjetor 2023:

1. Flumetralin

Gjithsej: 1 lëndë vepruese.

- Deri më 31 dhjetor 2023:

1. Amidosulfuron

2. Nicosulfuron

3. Clofentezine

4. Dicamba

5. Difenoconazole

6. Lenacil

7. Picloram

8. Bifenox

9. Diflufenican

10. Fenoxaprop-P

11. Fenpropidin

12. Dimethachlor

13. Etofenprox

14. Penconazole



15. Tri-allate
 16. Triflusalufuron
 17. Sulphur
 18. Tetraconazole
 19. Paraffin oils
 20. Paraffin oil
 21. 2-phenylphenol
 22. Prohexadione
 23. 8-hydroxyquinoline
 24. Fenpyrazamine
 25. Esfenvalerate
 Gjithsej: 25 lëndë vepruese.
 TOTALI: 52 (pesëdhjetë e dy) lëndë vepruese.

3. HIQEN LËNDËT VEPRUESE, SI MË POSHTË:

1.1,3-dichloropropene

Lënda vepruese 1,3-dichloropropene nuk është e miratuar.

2. Chloropicrin

Lënda vepruese chloropicrin nuk është e miratuar.

3. Isopirazam

- Të kryhet çregjistrimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë *isopirazam*, brenda datës 8 shtator 2022;

- Heqja nga tregu i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë *isopirazam*, të përfundojë brenda datës 8 dhjetor 2022.

4. Penflufen

- Të kryhet çregjistrimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë *penflufen*, brenda datës 26 mars 2023;

- Heqja nga tregu i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë *penflufen*, të përfundojë brenda datës 26 shtator 2023.

Gjithsej: 4 (katër) lëndë vepruese.

4. ZËVENDËSOHEN KUSHTET TE KOLONA “DISPOZITAT SPECIFIKE”

1. Paraffin oils CAS No 64742-46-7, CAS No 72623-86-0 dhe CAS No 97862-82-3. Kolona “Dispozitat specifike” zëvendësohet si vijon: Pjesa A: Mund të regjistrohen vetëm për përdorime si insekticide, akaricide dhe fungicide. Pjesa B: Për implementimin e parimeve uniformë, konkluzionet e raportit të rishikimit për vajrat parafine CAS No 64742-46-7, CAS No 72623-86-0 dhe CAS No 97862-82-3, të merren parasysh.

Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, kur është e nevojshme.

URDHËR

Nr. 540, datë 15.9.2022

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR PRIVAT, KOPSHTI “ZUBEYDE HANIM”, TIRANË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 3, të nenit 70, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

KONSTATOJ:

Me urdhrin nr. 277, datë 14.9.2022, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar është ngritur grupi i punës, i cili ka kryer verifikimet e nevojshme pranë institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshti “Zubeyde Hanim”, Tiranë, dhe në bazë të pikës 3, të nenit 70, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, ka propozuar: “Heqjen e licencës për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshti “Zubeyde Hanim”, Tiranë, hapur me urdhrin nr. 67, datë 15.10.1998, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

Heqja e licencës për ushtrimin e veprimtarisë së këtij kopshti bëhet për shkak të konstatimit të shkeljeve të rënda të legjislacionit në fuqi, që përbëjnë mosplotësim të kushteve të licencimit, për institucionin arsimor parauniversitar privat, kopshti “Zubeyde Hanim”, Tiranë, të evidentuar në Raportin e Vlerësimit nr. 1697/7 prot., datë 14.9.2022, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, si më poshtë:

- Institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti “Zubeyde Hanim”, Tiranë, ushtron aktivitetin në një godinë, për të cilin nuk është marrë miratimi nga ministri përgjegjës për arsimin dhe institucioni përkatës i licencimit, në kundërshtim me pikën 2, të nenit 43, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe mosplotësimin të rekomandimit të lënë brenda afatit kohor të përcaktuar në raportin e vlerësimit të DPAP-së, me nr. 249/100 prot., datë 12.5.2022.



PËR KËTO ARSYE,

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 3, të nenit 70, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bazuar në Raportin e Vlerësimit nr. 1697/7 prot., datë 14.9.2022, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshti “Zubeyde Hanim”, Tiranë, në emër të personit juridik “Turgut Ozal Education” sh.a., i hapur me urdhrin nr. 67, datë 15.10.1998, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

2. Institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti “Zubeyde Hanim”, Tiranë, ka këto detyrime:

a) Të kthejë pagesat e kryera nga prindi/përfaqësuesi ligjor i fëmijës për pjesën e papërfunduar të frekuentimit të kopshtit, për vitin shkollor 2022–2023, si dhe çdo detyrim tjetër të përmbushur, nëse ka.

b) Të pajisë çdo fëmijë me dokumentacionin e nevojshëm shkollor, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar.

c) Të vendosë në dispozicion të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër.

d) Të mbulojë të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e fëmijëve, në zbatim të këtij urdhri.

e) Të dorëzojë në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë e kryer.

3. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, nën juridiksionin e të cilit ndodhet institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti “Zubeyde Hanim”, Tiranë ka për detyrë:

a) Të ngrejë grup pune brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshti “Zubeyde Hanim”, Tiranë.

b) Të marrë masat për transferimin e fëmijëve në institucione të tjera të arsimit parauniversitar për të gjithë fëmijët e regjistruar në këtë institucion arsimor parauniversitar privat.

c) Të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga ky institucion arsimor parauniversitar privat.

d) Të ruajë në arkivin e institucionit dhe më tej të arkivojë, sipas legjislacionin në fuqi për arkivat, dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti “Zubeyde Hanim”, Tiranë.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Durrës të monitorojnë veprimtarinë e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, Tiranë, për zbatimin e detyrave, sipas këtij urdhri.

5. Në rast moszbatimi të detyrimeve, nga institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti “Zubeyde Hanim”, Tiranë, të përcaktuar në pikën 2 të këtij urdhri, institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të marrë të gjitha masat, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Urdhri nr. 67, datë 15.10.1998, i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, shfuqizohet.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin në MAS, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Durrës, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë, institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti “Zubeyde Hanim”, Tiranë dhe personi juridik “Turgut Ozal Education” sh.a.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi



VENDIM
Nr. 220, datë 1.9.2022

**MBI MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË
RREGULLOREN PËR PROCEDURAT
DHE AFATET PËR DHËNIEN,
MODIFIKIMIN, TRANSFERIMIN,
RINOVIMIN, NJOHJEN DHE HEQJEN
E LICENCEVE NË SEKTORIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 39, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 15 dhe nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordin i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 1.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës me nr. 1504/3, datë 29.8.2021, “Mbi miratimin e rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, rinovimin, transferimin dhe njohjen e licenceve në sektorin e energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordin i ERE-s, me vendimin nr. 138, datë 7.6.2021, filloi procedurën për rishikimin e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licenceve në sektorin e energjisë elektrike”.

- ERE, me njoftimin nr. 6/16 prot., datë 7.6.2021, ka publikuar në medien e shkruar fillimin e kësaj procedure dhe me shkresën nr. 742 prot., datë 10.6.2021, i është drejtuar palëve të interesit: Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Autoritetit të Konkurrencës (AK), Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a., Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), Shoqatës së Investitorëve të Huaj në Shqipëri (FIAA), Shoqatës Shqiptare të Energjisë së Rinovueshme (AREA) dhe Këshillit Evropian të Rregullatorëve të Energjisë (ACERC) për marrje mendimi rreth ndryshimeve të propozuara.

- Në përfundim të afatit të pritjes së komenteve nga palët, rezulton se kanë depozituar komente dhe sugjerime: MIE, Furnizuesi i Shërbimit Universal

(FSHU) sh.a. dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, të cilat janë marrë kryesisht në konsideratë gjatë hartimit të ndryshimeve të kësaj rregulloreje.

- Sa u përket përcaktimeve të ligjit nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, është konstatuar se ato nuk prekin nenet e rregullores për të cilat ishte propozuar ndryshimi, nenin 8 dhe aneksin A të Rregullores. Në këto rrethana aneksi A do të ketë përcaktime për pagesat, sipas llojit të aplikimit, por nuk do të jetë format që do të plotësohet nga aplikuesi.

- Nisur nga rastet praktike të konstatuara dhe duke marrë në konsideratë dhe vendimet e qeverisë shqiptare, ku synohet që të shmanget marrja fizike e shumë prej dokumenteve/akteve administrative, duke bërë të mundur aksesimin *online* të tyre, është vlerësuar të rishihet dokumentacioni që depozitohet nga aplikuesit referuar llojit të aplikimit. Në këtë kontekst vlerësohet që aplikuesit të depozitojnë në ERE dokumente me nënshkrim apo vulë elektronike, në rastet kur kjo aplikohet, i cili është pa kosto për subjektin dhe disponohet prej tij nëpërmjet sistemit *online*.

- Vlerësohet që aplikuesit të depozitojnë në ERE vetëm dokumentacionin që konsiderohet i vlefshëm dhe i mjaftueshëm për dhënie/modifikimin/rinovimin apo transferimin e një licence dhe jo dokumentacion të cilin e ka depozituar më parë, me qëllim marrjen e miratimit/autorizimit apo lejeve nga autoriteti shtetëror/organi përgjegjës (si në rastin e prodhimit të energjisë elektrike) dhe të dhënat përkatëse të nevojshme gjende të këto miratime apo autorizime.

- Nisur nga shqyrtimi i rasteve praktike, është vlerësuar edhe që në disa pika të Rregullores të bëhen qartësime/saktësime të mtejshme për subjektet sa i takon informacionit apo dokumentacionit që duhet të depozitojnë, pa ndryshuar qëllimin e nenit përkatës.

- Gjithashtu është bërë një rikonceptim i të dhënave identifikuese të subjekteve, deklaratave dhe të dhënave teknike (në varësi të llojit të aplikimit) dhe për arsye të aplikimit janë përgatitur formularë të veçantë, të cilat janë në formën e shtojcave dhe pjesë integrale e rregullores, që plotësohen dhe nënshkruhen nga aplikuesi dhe depozitohen në ERE së bashku me dokumentacionin tjetër të aplikimit.



- Është vlerësuar dhe rishikimi i aneksit A miratuar sa u takon pagesave sipas llojit të aplikimit.

- Ndryshimet e rregullores janë konceptuar në një dokument të veçantë që do t'i bashkëlidhet këtij vendimi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” (bashkëlidhur ndryshimet).

2. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

NDRYSHIMET E PROPOZUARA NË “RREGULLOREN PËR PROCEDURAT DHE AFATET PËR DHËNIEN, MODIFIKIMIN, TRANSFERIMIN, RINOVIMIN/NJOHJEN OSE HEQJEN E LICENCAVE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 109, DATË 29.6.2016, I NDRYSHUAR

- Kudo në rregullore, togfjalëshi “ditë pune” zëvendësohet me “ditë”.

- Në nenin 3 hiqet përkufizimi për “drejtuesit kryesorë” dhe ndryshon përkufizimi për të deleguarin përgjegjës dhe shtohen përkufizimet për “stafin teknik” dhe “dokumentacionin thelbësor” si vijon:

“Përfaqësues me prokurë/autorizim” do të thotë një person fizik/juridik që aplikon për një licencë në emër të aplikuesi, sipas aktit përkatës të përfaqësimit.

“Staf teknik” do të thotë staf administrativ, ligjor apo inxhinierik, dhe/ose mbështetës, në funksion të veprimtarisë së licencuar.

“Dokumentacion thelbësor” do të thotë çdo leje/autorizim/miratim e lëshuar nga autoritetet / organet përgjegjëse, që është i domosdoshëm për ushtrimin e veprimtarisë së licencuar.”.

- Kudo në rregullore, togfjalëshi “i deleguari përgjegjës”, zëvendësohet me “përfaqësues me prokurë/autorizim”.

- Në nenin 4, “Licencat”, pika 2 ndahet në pikat 2 dhe 3 dhe pikat 3, 4, 5 dhe 6 bëhen pikat 4, 5, 6 dhe 7, si vijon:

2. Për operimin e një linje direkte nuk nevojitet licencë transmetimi apo shpërndarjeje.

3. Nuk janë të detyruar të pajisen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike:

a) vetëprodhuesit, të cilët nuk janë të lidhur me rrjetin kombëtar ose, kur lidhja me rrjetin kombëtar bëhet për qëllime të mirëmbajtjes së njësisë së tij të prodhimit;

b) prodhuesit, përfshirë edhe vetëprodhuesit e lidhur me rrjetin kombëtar, me kapacitet të instaluar deri në 1 mw.

- Në nenin 7, “Delegimi i të drejtave të aplikuesit”, bëhen këto ndryshime:

- Pika 1 ndryshon si vijon:

“1. Aplikuesi mund të caktojë një individ / person si përfaqësues me prokurë/autorizim, i cili do ta përfaqësojë atë në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me aplikimin, brenda kompetencave të dhëna në aktin e përfaqësimit për këtë qëllim.”.

- Pika 2 shfuqizohet.

- Në nenin 8, “Paraqitja e aplikimit”, bëhen këto ndryshime:

- Pika 1 ndryshon si vijon:

“1. Aplikimi ka të bëjë me plotësimin e shtojcave përkatëse, sipas llojit të aplikimit, që referohen në nenin 9, si dhe dokumentacionit që përcaktohet në nenet 9, 15, 16 dhe 17 të kësaj Rregulloreje.”.

- Pika 5, ndryshon si vijon:

5. Dokumentacioni që depozitohet në formën e deklaratës nga aplikuesi, duhet të jetë i nënshkruar dhe/ose vulosur prej tij.



- Neni 9, “Formati dhe dokumentacioni për aplikim”, ndryshon si vijon:

“1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

1.1 Aplikuesi duhet të plotësojë formatin e aplikimit, sipas përcaktimeve të shtojcës 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

1.2 Aplikuesi duhet të depozitojë dokumentacionin juridik dhe administrativ, si më poshtë:

a) ekstraktin historik të regjistrit tregtar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB);

b) vërtetimin e gjendjes gjyqësore për shoqërinë, administratorin/administratorët e saj;

c) strukturën organizative të shoqërisë, e cila duhet të përmbajë stafin teknik, sipas veprimtarisë së licencuar;

d) në rast se aplikuesi do të caktojë një përfaqësues, duhet të depozitojë në ERE aktin e përfaqësimit (prokurë/autorizim).

1.3 Aplikuesi duhet të depozitojë dokumentacionin financiar dhe fiskal, si vijon:

a) vërtetim që nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve tatimore dhe atyre të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

b) bilancin financiar të 3 (tri) viteve të fundit/ose kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë e krijuara rishtazi), të audituar (kur kjo kërkohej nga ligji) dhe/ose dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe mbështetjen financiare (financim i vetë aplikuesit, kredi ose garanci bankare, donacion etj.) për ushtrimin e veprimtarisë, sipas llojit të aplikimit, bazuar në këtë dokumentacion. (Në rastin e veprimtarisë së tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike, mbështetja financiare duhet të garantojë të paktën 1 (një) muaj të ushtrimit të aktivitetit, referuar sasisë së parashikuar nga vetë aplikuesi);

c) planin e biznesit, ku të ketë përcaktime në lidhje me parashikimin vjetor të kostove, shitjeve, të ardhurave dhe financimin e projektit/ushtimit të veprimtarisë së licencuar).

2. Dokumentacioni specifik, sipas tipit të licencës

2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë, gjithashtu:

a) formatin e plotësuar me të dhënat teknike sipas shtojcës 2;

b) marrëveshjen e koncesionit/autorizimit apo çdo formë tjetër të marrëveshjes në rastet e

aplikueshme të lidhur me institucionet përgjegjëse të ngarkuara me ligj, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në fuqi;

c) miratimin e operatorit të rrjetit (OST sh.a. ose OSSH sh.a.) për lidhjen e centralit/centraleve me rrjetin elektrik;

d) lejen e përdorimit të burimit ujor për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet;

e) miratimin nga organet përkatëse të menaxhimit dhe mbrojtjes së mjedisit (VNM, deklaratë mjedisore, leje);

f) miratimin e projektit të digës nga Komiteti Kombëtar i Digave (në rastet e objekteve me digë).

2.2 Për t’u pajisur me licencë për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë, gjithashtu:

a) formatin e plotësuar me të dhënat teknike, sipas shtojcës 3;

b) diagramin e sistemit të transmetimit, që tregon elementet ekzistuese dhe ato të perspektivës në format A1;

c) planin e zhvillimit të rrjetit;

d) numrin e punonjësve të kategorizuar sipas profesioneve.

2.3 Për t’u pajisur me licencë për operimin e sistemit të shpërndarjes të energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë, gjithashtu:

a) formatin e plotësuar me të dhënat teknike, sipas shtojcës 4.

b) diagramin e sistemit të shpërndarjes, që tregon elementet ekzistuese dhe ato të perspektivës;

c) planin e zhvillimit të rrjetit;

d) plan-veprimin për uljen e humbjeve teknike dhe joteknike;

e) plan-veprimin për përmirësimin e cilësisë së shërbimit;

f) numrin e punonjësve të kategorizuar sipas profesioneve;

g) të dhëna për matjen dhe për sistemet IT.

2.4 Për t’u pajisur me licencë për furnizimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë, gjithashtu:

a) informacion mbi sasinë e energjisë elektrike (në Gwh) të parashikuar për t’u furnizuar gjatë 5 (pesë) viteve të ardhshme të licencës;

b) informacion mbi sistemin IT, me të cilin do të operojë veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien



në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi, me qëllim realizimin e procesit të faturimit për klientët;

c) informacion mbi disponimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit, me adresat përkatëse të vendndodhjes së tyre;

d) informacionin mbi nivelin e tensionit dhe mënyrën e realizimit të matjes për klientët.

2.5 Për t'u pajisur me licencë për tregtimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë, gjithashtu, informacion mbi sasinë e energjisë elektrike (në GWh) të parashikuar për t'u tregtuar gjatë 5 (pesë) viteve të ardhshme të licencës.

2.6 Për t'u pajisur me licencë për operimin e tregut të energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë, gjithashtu:

a) numrin e punonjësve të kategorizuar sipas profesioneve;

b) informacion për zotërimin e harduerit dhe softuerit të nevojshëm për operimin e tregut, sipas rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike dhe akteve të tjera për këtë qëllim;

c) informacion dhe dokumentacion, që vërteton mundësinë për të zhvilluar të gjitha procedurat operacionale, kontraktuale ose marrëdhëniet e aksesit, përfshirë shërbimet për likuidimet (*clearing*).

d) rregulloret përkatëse të miratuara nga organet drejtuese, që lidhen me mekanizmin për mbikëqyrjen e tregut, procedurat dhe kontrollet për mbrojtjen e informacionit konfidencial;

e) çdo dokumentacion tjetër që lidhet me bashkëpunimin, në kuadër të veprimtarisë së operimit të tregut të energjisë elektrike.

2.7 Për t'u pajisur me licencë për veprimtarinë e sistemeve të mbyllura të shpërndarjes së energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë, gjithashtu:

a) elementet e sistemit të mbyllur të shpërndarjes;

b) burimin e furnizimit me energji elektrike të këtij sistemi;

c) informacion mbi klientët e këtij sistemi, me kapacitetet e instaluara përkatëse;

- Në nenin 10, "Shqyrtimi i aplikimit", bëhen këto ndryshime:

- Në pikën 1, togfjalëshi "nenet 8 dhe 9" ndryshojnë dhe bëhen në "nenet 8, 9, 15, 16, dhe 17".

- Në pikën 3, hiqet grupi i fjalëve "dhe në relacionin e sipërpërmendur".

- Në pikën 5, "refuzimi" zëvendësohet me "mosfillimi të procedurës".

- Pika 6 shfuqizohet.

- Pika 7 ndryshon si vijon:

7. Nëse aplikuesi, brenda 1 (muaji) nga marrja dijëni e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

- Në pikën 8, grupi i fjalëve "ERE publikon në median e shkruar" zëvendësohet me grupin e fjalëve "ERE publikon në faqen e saj zyrtare të internetit dhe në median e shkruar", dhe togfjalëshi "tri gazeta" zëvendësohet me "dy gazeta".

- Pika 10 ndryshon si vijon:

"10. Duke nisur nga dita e parë e publikimit të njoftimit, ERE do të presë kundërshtimet e mundshme për këtë aplikim, për një afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga data e parë e publikimit të njoftimit për aplikimet për veprimtarinë e prodhimit për centralet e lidhura me rrjetin e transmetimit."

- Pika 11 ndryshon si vijon:

"11. Për aplikimet për veprimtarinë e prodhimit për centralet e lidhura drejtpërdrejt me rrjetin e shpërndarjes dhe për aplikimet e tjera, sipas përcaktimeve të kësaj Rregulloreje, afati i përcaktuar në pikën 10 do të jetë 10 (dhjetë) ditë."

- Pika 12 ndryshon si vijon:

"12. Me kërkesë me shkrim, aplikuesi mund të kërkojë që të mbahen konfidenciale informacione ose dokumente të depozituara prej tij në kuadër të aplikimit, që mund t'i shkaktojnë atij dëm tregtar. Ky dokumentacion duhet të specifikohet prej tij, së bashku me arsyet e mosbërjes publike. Përndryshe, konsiderohet se kërkuksi nuk e kërkon një kufizim të tillë. Kjo kërkesë, në zbatim të përcaktimeve të legjislacionit në fuqi mbi informacionin konfidencial dhe të drejtën e informimit, do të mbahet në konsideratë në vijim, në rast të interesit të palëve të treta për të aksesuar dokumentacionin e aplikimit."

- Neni 12 emërtohet "Analizimi i dokumentacionit dhe propozimi përfundimtar".

- Në nenin 13 bëhen këto ndryshime:

- Pika 2, germa "i" ndryshon, si vijon:

"i. nxitjen e një tregu konkurrues të energjisë elektrike;"

- Në nenin 14, "Pranimi ose refuzimi për licencim i aplikuesit", shtohen pikat 8, 9 dhe 10, si vijon:



8. Në rast se i licencuari humbet dokumentin origjinal të licencës së lëshuar nga ERE, ai mund të bëjë kërkesë në ERE për lëshim duplikate licenceje, kundrejt një pagese, siç përcaktohet në aneksin A të kësaj Rregulloreje. Të licencuarit do t'i lëshohet dublikata e licencës vetëm pasi të vërtetohet se ai ka kryer pagesën përkatëse.

9. ERE mund marrë vendim me kusht kur gjykon se ndonjë nga dokumentet e paplotësuar nuk është thelbësore dhe i licencuari merr përsipër ta përmbushë atë brenda një periudhe të caktuar kohore të përcaktuar në vendim. Plotësimi/mosplotësimi i kushtit sipas përcaktimit të vendimit të Bordit të ERE-s do të përbëjë shkak për rishikimin e vendimit.

10. Bordi i ERE-s, rast pas rasti, pas fillimit të procedurës, mund të vendosë të pezullojë vendimarrjen e tij.

- Në nenin 15, “Modifikimi i licencës”, pika 4, ndryshon si vijon:

“4. Në rastin e modifikimit të licencës me kërkesë të të licencuarit, ky i fundit duhet të depozitojë në ERE:

a) formatin e plotësuar të aplikimit sipas shtojcës 1;

b) informacion ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës dhe çdo parametër teknik që ndryshon;

c) vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës;

d) miratimin/qëndrimin e Autoritetit Kontraktues (ministria përgjegjëse);

e) miratimin/qëndrimin e organeve përgjegjëse të menaxhimit dhe mbrojtjes së mjedisit;

f) miratimin/qëndrimin e organeve përgjegjëse të menaxhimit të burimeve ujore, në rastet e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet;

g) miratimin/qëndrimin e operatorit të rrjetit, në lidhje me këtë modifikim, në rastet e ndryshimit të kapacitetit të instaluar.”.

- Në nenin 16, “Rinovimi i licencës”, bëhen këto ndryshime:

- Pika 1 ndryshon si vijon:

“1. Në rast të interesit për rinovimin e licencës, i licencuari duhet të paraqesë aplikimin përkatës në ERE për rinovim jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë, duke paraqitur dokumentet e mëposhtme:

a) formatin e plotësuar të aplikimit, sipas shtojcës 1;

b) çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë;

c) informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur).”.

- Pas pikës 7, shtohet pika 8, me përmbajtje si vijon:

“8. Në rast se i licencuari nuk paraqet në ERE aplikim për rinovimin e licencës, brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ose ERE merr vendim për refuzimin e kërkesës së të licencuarit për rinovim të licencës, kjo e fundit e humbet vlefshmërinë me përfundimin e afatit të kohëzgjatjes së saj dhe hiqet nga regjistri i të licencuarve të ERE-s. Në këto rrethana, në rast të interesit për të ushtruar sërish veprimtarinë, duhet të paraqitet aplikim për licencim nga e para, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.”.

- Në nenin 17, “Transferimi i licencës”, bëhen këto ndryshime:

- Pika 2 ndryshon si vijon:

“2. Në rastet e transferimit të plotë të licencës, i licencuari duhet të paraqesë në ERE dokumentet e mëposhtme:

a) formatin e plotësuar të aplikimit, sipas shtojcës 1;

b) informacion ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për transferimin e licencës;

c) informacion mbi ndikimet e pritshme të transferimit të licencës;

d) marrëveshjen e nënshkruar mes të licencuarit dhe personit tek i cili do të transferohet licenca, ku të shprehet vullneti për këtë transferim;

e) deklaratë me shkrim e personit tek i cili do të transferohet licenca, ku të shprehet gatishmëria për të vijuar me ushtrimin e veprimtarisë së licencuar dhe kontributi financiar që do të vendoset në dispozicion të veprimtarisë;

f) miratimin/qëndrimin e Autoritetit Shtetëror Përgjegjës, në rast se transferimi kushtëzohet me një miratim/qëndrim të tillë.”.

- Pika 5 ndryshon si vijon:

“5. Në rastet e transferimit të plotë ose të pjesshëm të licencës, që shoqërohet dhe me transferimin e aseteve fikse të të licencuarit, aplikimi për këtë transferim duhet të bëhet



paralelisht me aplikimin për transferimin e licencës, sipas përcaktimeve të ‘Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit’.”.

- Neni 23, “Hyrja në fuqi”, ndryshon si vijon:

“Këto shtesa dhe ndryshime hyjnë në fuqi pas Botimit në Fletoren Zyrtare.”.

VENDIM

Nr. 233, datë 12.9.2022

MBI SHQYRTIMIN E ANKESËS SË KONSUMATORIT A.Ç. NDAJ FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL FSHU SHA DHE OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES OSSH SHA

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 23, pika 12, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; nenin 9 të “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.7.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve me nr. 1379 prot., datë 25.7.2022, “Mbi shqyrtimin e ankesës së konsumatorit A.Ç. ndaj Furnizuesi të Shërbimit Universal FSHU sh.a. dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a.,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 85 prot., datë 4.5.2022 dhe nr. 85/1 prot., datë 6.5.2022, konsumatori i energjisë elektrike z. A.Ç., ka paraqitur ankim në ERE, si rezultat i ndërprerjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a. Konsumatori, në ankesën e tij sqaron se apartamenti i banimit është disponuar me marrëveshje me administratorin e shoqërisë ndërtuese dhe si rrjedhojë e punimeve të kryera nga z. A.Ç., administratori i shoqërisë i ka dhënë një apartament të cilin klienti e ka ndërtuar dhe përfunduar në vitin 2010.

- ERE, me anë të shkresës me nr. 85/2 prot., datë 11.5.2022, ka trajtuar ankesën e z. A.Ç. gjyqësisht, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjes, me objekt: detyrimin e të paditurit për të dëmshpërblyer paditësin për përdorimin e pasurisë së paluajtshme. Gjithashtu, rezultoi se Gjykata e Apelit ka vendosur rrëzimin e kërkesës së paditësit për vendosjen e masës së sigurisë, me objekt: “Lirimin dhe vendosjen në posedim të palës paditëse të apartamentit me nr. 18/330 ND”.

- ERE, me qëllim zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje, me shkresën me nr. 884/1 prot., datë 3.6.2022, ka njoftuar shoqërinë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., dhe konsumatorin z. A.Ç. për zhvillimin e një seance dëgjimore më datë 15.6.2022, ora 10:00.

- Përfaqësuesit e ERE-s në këtë seancë bënë me dije se, që në rekomandimin e fundit të përcjellë nga ERE, i është kërkuar OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a. që t’i japë zgjidhje ankesës së konsumatorit, duke adresuar kërkesën e tij për sigurimin e furnizimit me energji. Nga OSSH sh.a. nuk ka pasur asnjë përgjigje, ndërsa FSHU sh.a. i është përgjigjur kërkesës së ERE-s, duke dhënë zgjidhjet më praktike në vlerësimin e saj.

- ERE ka vijuar me dërgimin e shkresës me nr. 884/2 prot., datë 21.6.2022, “Vijim komunikimi pas seancës dëgjimore” drejtuar OSSH sh.a., FSHU sh.a. dhe në dijeni z. A.Ç. Në vijim të shkresës së sipërcituar në ERE nuk është depozituar asnjë informacion se si ka vijuar situata me sa kërkohet nga asaj.

- Rezultoi se konsumatori ka depozituar ankesën pranë FSHU sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 3102 prot., datë 1.4.2022, gjithashtu, me shkresën nr. 3922 prot., datë 21.4.2022 ka depozituar sërish ankesë në OSSH sh.a. Me shkresën nr. 3077 prot., datë 21.4.2022, ka ushtruar ankesë pranë FSHU sh.a. Më datë 4.5.2022, me shkresën nr. 85, konsumatori ka ushtruar ankesë pranë ERE-s.

- ERE, me anë të shkresave me nr. 85/2 prot., datë 11.5.2022, nr. 85/3 prot., datë 24.5.2022 dhe nr. 85/5 prot., datë 31.5.2022, ka dhënë në mënyrë të përsëritur të njëjtat rekomandime për zgjidhjen e ankesës.

- ERE e ka ndërmarrë këtë hap procedural, me qëllim kuptimin e problematikës dhe shkaqeve ligjore apo teknike që kanë penguar të licencuarin



të zbatohet rekomandimet e ERE për zgjidhjen e ankesës.

- Rezulton se ERE, në mënyrë të përsëritur është shprehur me zgjidhje për të njëjtat rrethana, mes të njëjtave palë, e në mënyrë të paargumentuar nga ana e të licencuarit FSHU sh.a., e për rrjedhojë edhe OSSH sh.a. (i cili vepron për përmbushjen e detyrimeve të ngarkuara me ligj, mbështetur në kërkesat e veprimet e urdhëruara nga FSHU sh.a., sa i përket rilidhjes së konsumatorëve të kësaj të fundit) nuk janë reflektuar këto rekomandime në veprime konkrete që çojnë në zgjidhjen e ankesës.

- ERE vlerëson se plotësohen kushtet për daljen me një vendim, në lidhje me zgjidhjen e kësaj anekese, deri sa gjykata të shprehet më një vendim të formës së prerë e nëse ky vendim ndryshon statusin e përdoruesit të kontratës në raport me pronën e cila furnizohet me energji elektrike.

- Në kuptim të qëndrimeve të Gjykatës së Apelit me nr. vendimi 20-2020-505/138, por edhe Gjykatës së Lartë me nr. vendimi 2021-47, përdoruesit të objektit të furnizuar, i cili në këtë rast është edhe titullari i librezës së energjisë elektrike, por edhe likuiduesi i të gjitha detyrimeve karshi furnizuesit që nga marrja në posedim e objektit, i është njohur e drejta e përdorimit të objektit deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë nga gjykata, ai ka të drejtën që të gëzojë posedimin e të drejtat që burojnë prej pronës.

- Për sa më sipër, është e qartë që qëndrimi i Gjykatës nuk lë vend për interpretime të tjera, përveç rikthimit të palëve në gjendjen e mëparshme duke kërkuar nga OSSH sh.a., të rilidhë konsumatorin z. A.Ç. me rrjetin dhe FSHU sh.a., të garantojë furnizimin e vazhdueshëm me energji elektrike, sikurse është proceduar nga palët përpara ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike.

- Sa më sipër, statusi i përdoruesit të kontratës për klientin në raport me furnizuesin FSHU sh.a., është fakt i pranuar dhe i pakontestuar nga palët, e mbi të gjitha, vendimi i sipërcituar i gjykatave, ka krijuar themelin e nevojshëm ligjor për të mos lënë vend për propozime të ndryshimit të statusit të këtij klienti në raport me pronën dhe të drejtën e gëzimit të saj deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë nga gjykata që po shqyrton themelin e padisë ndërmjet palëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. FSHU sh.a. dhe OSSH sh.a. të marrin masa për rikthimi e palëve në mosmarrëveshje në gjendjen juridike që gëzonin përpara ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike, deri në përfundimin e hetimit gjyqësor dhe daljen në vendimin e formës së prerë nga Gjykata, në çështjen me objekt të padisë “detyrimin e të paditurit për të dëmshpërblyer paditësin për përdorimin e pasurisë së paluajtshme”, me palë paditëse titullarin e kontratës së furnizimit me energji elektrike dhe të paditur përdoruesin/konsumatorin.

2. FSHU sh.a. dhe OSSH sh.a. të raportojnë në ERE për përmbushjen e parashikimeve të pikës 1 të këtij vendimi, jo më vonë se 5 ditë nga hyrja në fuqi e tij.

3. Konsumatori, FSHU sh.a. dhe OSSH sh.a. të bëjnë me dije në ERE, për çdo ndryshim që mund të prodhojë vendimi i formës së prerë të gjykatës në përfundim të hetimit gjyqësor.

4. Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve të njoftojë shoqëritë OSSH sh.a., FSHU sh.a. dhe konsumatorin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 379, datë 31.8.2022****PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
UJËSJELLËS-KANALIZIME KURBIN SHA**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”(VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e 567 përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 31.8.2022 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kurbin sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Ujësjellës Kanalizime Kurbin me shkresën nr. 246 prot., datë 15.08.2022, ka paraqitur kërkesën pranë ERRU për rinovim licence të shoqërisë për kategorinë A të shërbimit - grumbullimi dhe shpërndarja e ujit për konsum publik dhe kategorinë C të shërbimit - largimi i ujërave të ndotura, për efekt të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Kurbin në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezultoi:

a) Shoqëria UK Kurbin ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 30 212 banorë të Bashkisë Kurbin për tri njësitë administrative: Laç, Mamurras, Milot.

b) drejtuesi ligjor z. Drilon Aliu është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë.

c) drejtuese teknike znj. Junilda Elezi është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, dega Inxhinieri Hidroteknikë në vitin 2007 dhe ka mbi 5 vjet përvojë në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Kurbin, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Kurbin është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kurbin sh.a., me (NUIS K07628310A), në kategoritë:

a) kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) kategoria C – Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Kurbin sh.a autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara, me:

a) drejtues ligjor – Drilon Aliu;

b) drejtues teknik – Junilda Elezi.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kurbin sh.a është Bashkia Kurbin.

Njësitë administrative: Laç

- Mamurras

- Milot

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.



5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Kurbin sh.a. detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Kurbin sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 380, datë 31.8.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 130, DATË
11.11.2020, “PËR LICENCIMIN E SHA
UJËSJELLËS-KANALIZIME VORË”

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 31.08.2022 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 130, datë 11.11.2020 Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Vorë”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Vorë (UK Vorë), me shkresën nr. 448 prot., datë 8.8.2022, me lëndë “Shkresë përcjellëse” ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe

Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesin ligjor të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe rregullores së licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Vorë për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Vorë me vendimin nr. 130, datë 11.11.2020, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Vorë, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuese ligjore e shoqërisë UK Vorë sh.a. znj. Ivi Koja, ka përfunduar studimet e larta në Inxhinieri Hidroteknike në vitin 2011.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK VORË sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Vorë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR-së nr. 130, datë 11.11.2020, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Vorë “bëhen këto ndryshime:

“Drejtues ligjor znj. Ivi Koja”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani



VENDIM
Nr. 381, datë 31.8.2022

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË
SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË
DHE LARGIMIN E UJËRAVE TË
NDOTURA PËR SHOQËRINË
UJËSJELLËS-KANALIZIME BULQIZË
SHA**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 39), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 40), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015 “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

Në mbledhjen e datës 31.8.2022 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e UK Bulqizë sh.a. për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime, me anë të shkresës nr. 387 prot., datë 1.9.2021, me lëndë “Kërkesë për nivel të ri tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin (kanalizime) e

ujërave të ndotura”, plotësuar dokumentacioni me shkresën nr. 579 prot., datë 16.12.2021, të paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për ndryshimin e tarifave në zonën e shërbimit për të tria kategoritë e konsumatorëve, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe vendimin nr. 40, të KKRR-së,

VËREN SE:

1. Paraqitja e kërkesës për vendosjen e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura dhe tarifën fikse të shoqërisë UK Bulqizë është në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin nr. 40, dhe me vendimin 538, datë 30.12.2021 vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për propozimin e bërë nga UK Bulqizë për nivel të ri tarifor për shërbimet UK për të gjithë zonën e riorganizuar të shërbimit në zbatim të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

2. Ujësjellës-Kanalizime Bulqizë në dokumentacionin e paraqitur pranë ERRU-së, me shkresën nr. 387 prot., datë 1.9.2021, plotësuar dokumentacioni me shkresën nr. 579 prot., datë 16.12.2021 “Kërkesë për nivel të ri tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura” propozon ndryshim të nivelit tarifor për të tre kategoritë e konsumatorëve, sipas tabelës nr. 1, ku sipas nivelit tarifor që aplikohet aktualisht nga shoqëria, zonat e shërbimit janë grupuar si më poshtë:

Zona 1 përfshin njësinë administrative: Bulqizë, Gjoricë;

Zona 2 përfshin njësinë administrative: Shupenzë, Ostren;

Zona 3 përfshin njësinë administrative: Zerqan, Fushë-Bulqizë, Trebisht;

Zona 4 përfshin njësinë administrative: Krastë.



Tabela 1. Tarifat aktuale dhe të propozuara nga shoqëria sipas kategorisë së konsumatorëve

Kategoria e klientëve	Zona e shërbimit											
	Tarifat aktuale				Tarifat e propozuara				Ndryshimi			
	Zona 1	Zona 2	Zona 3	Zona 4	Zona 1	Zona 2	Zona 3	Zona 4	Zona 1	Zona 2	Zona 3	Zona 4
A. Shërbimi i FU (me matës)	Lek/m ³				Lek/m ³				Lek/m ³			
1. Klientë familjarë	17	25	17	-	25	25	20*	-	+8	0	+3	-
2. Klientë publikë	55				75				+20			
3. Klientë publikë (spitalet)	45				55				+10			
4. Klientë privatë	75				83.3				+8.3			
B. Shërbimi i FU (pa matës)	Lek/muaj/ lidhje			Lek/m ³	Lek/muaj/ lidhje			Lek/m ³	Lek/muaj/ lidhje			Lek/m ³
1. Klientë familjarë (Krahtë)	316	316	250	30	400	400	316	25	+84	+84	+96	-5
C. Shërbimi i KUN	Lek/m ³				Lek/m ³				Lek/m ³			
1. Klientë familjarë	0				10				+10			
2. Klientë publikë	0				17				+17			
3. Klientë publikë (spitalet)	0				15				+15			
4. Klientë privatë	0				17				+17			
D. Tarifë fikse shërbimi	Lek/muaj/ lidhje				Lek/muaj/ lidhje				Lek/muaj/ lidhje			
1. Klientë familjarë	100	100	0	100	100				0	0	+100	0
2. Klientë publikë	100				100				0			
3. Klientë publikë (spitalet)	100				100				0			
4. Klientë privatë	100				100				0			

*Shoqëria ka kërkuar unifikimin e tarifës volumetrike në nivelin **25 lekë/m³** në të gjithë zonën e shërbimit, nëpërmjet një kërkesë dërguar me e-mail, duke trajtuar nivelin e kërkuar të tarifës volumetrike për zonën 3 prej 20 lekë/m³, si një lapsus në dokumentacionin e dërguar për aplikim.

3. Shoqëria UK Bulqizë, sipas të dhënave të pranuar ofron shërbimin e furnizimit me ujë me treguesit e performancës, përkatësisht: mbulimi me shërbime të FU në 46.5% të popullsisë në zonën e juridiksionit të saj, shërbimin e largimit të ujërave të ndotura për 20.9% të popullsisë, uji pa të ardhura në nivelin 49.4%, normë korrente e arkëtimit prej 70.2%, nga shërbimet FU dhe KUN, UK Bulqizë mbulon kostot e operimit në nivelin 91.4%, ndërsa kostot totale i mbulon 90.8%.

4. Në aplikimin e shoqërisë me referencë vitin e mbyllur 2020, si dhe duke konsideruar tarifat e reja të propozuara, shoqëria ka përcaktuar gjithashtu objektivat që do realizohen në vitin 2022. Treguesit kryesorë të performancës për të dy vjetët, përkatësisht 2020–2021, si edhe objektivat për vitin 2022, jepen në tabelën e mëposhtme.

Tabela 2. Treguesit kryesorë të performancës sipas shoqërisë për vitet 2020–2021–2022

Treguesit e performancës	Njësia	Treguesit e performancës sipas shoqërisë		
		Viti 2020	Viti 2021 sipas raportimit	Viti 2022 Parashikimi
1. Uji pa të ardhura	%	49.4	46.3	27
2. Mbulimi me ujë	%	46.5	51	54
3. Mbulimi me KUN	%	20.9	21	21
4. Niveli i maties	%	23.4	25.0	70.5
5. Norma e arkëtimit korrent	%	70.2	81	83.4
6. Norma e arkëtimit të përgjithshëm	%	102	96.0	93
7. Vazhdimësia e furnizimit me ujë	orë/ditë	10	12	14
8. Efienca e stafit	staf/1000 lidhje UK	9.1	9.9	5.9
9. Mbulimi i kostove O&M	%	91.4	77.4	129.3
10. Mbulimi i kostove totale	%	90.8	69.2	129.3



5. Shoqëria në relacionin e saj e justifikon nevojën e ndryshimit të tarifave sipas argumenteve të mëposhtme:

a) Për arsye të riorganizimit në zbatim të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

b) aplikon për tarifa pas një periudhe 10 vjeçare nga vendimi i fundit për tarifa, i vitit 2012;

c) aplikimi për herë të parë për tarifë për shërbimin e kanalizimeve të ujërave të ndotur;

d) nevoja për të ardhura për mirëmbajtjen e rrjeteve dhe përmirësimin shërbimeve të ofruar.

6. Gjatë procesit të analizës teknike-ekonomike sipas metodologjisë së llogaritjes së tarifave të përcaktuar në vendimin nr. 42, ERRU-ja ka kërkuar informacion shtesë nga UK Bulqizë, si dhe verifikim të saktësisë së të dhënave të vëna në dispozicion nga shoqëria.

7. Në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe treguesve të performancës, si dhe në analizën ekonomike financiare, janë marrë në konsideratë përmbushja nga UK Bulqizë e kriterëve të mëposhtme:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes nëpërmjet vendosjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të shitjes apo e kushteve të tjera të tregimit;

c) kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar;

d) mbulimin 94% të kostos totale të nevojshme për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë;

e) orientimin drejt mbulimit të kostove të totale për shërbimet UK;

f) tarifat e propozuara nga operatori të jenë në përputhje të plotë me parimin ligjor rregullator mbi **përballueshmërinë** e tyre nga ana e konsumatorëve familjarë;

g) tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen;

h) propozimin për ndryshimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe miratimin e tarifave për herë të parë për shërbimin e kanalizimeve të ujërave të ndotur nga shoqëria, ERRU-ja e gjen të justifikuar, pothuajse në nivelin e propozuar nga shoqëria, referuar analizës tekniko- ekonomike, si dhe objektivave të performancës të përcaktuara.

8. Në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë konsiderohen të arritshëm objektivat e vendosur mbi treguesit e performancës dhe për këtë ERRU-ja rekomandon:

a) të verifikojë dhe të vlerësojë të dhënat mbi burimet ujore në lidhje me kapacitetet maksimale dhe shfrytëzueset për të gjithë muajt e vitit. Në vlerësimin e variablit “Ujë i prodhuar” të mbështetet në regjistrimet ditore në çdo depo dhe në kapacitetet mesatare mujore të burimeve në shfrytëzim;

b) të shfrytëzojë burimet ujore bazuar në kërkesën për ujë të popullsisë së zonës që do të furnizohet. Të mbajë në mënyrë tabelare të dhënat mbi zonat që furnizohen nga secili burim, popullsia e shërbyer, si dhe sasitë e prodhuara që hyjnë në sistemin e furnizimit të çdo zone;

c) të vlerësojë nevojat, dhe të bëjë përpjekje për t’i pajisur me ujëmatës të gjitha burimet e shfrytëzueshme prej saj;

d) të trajnojë stafin profesionist mbi njohjen, hartimin e bilancit të ujit dhe përlllogaritjen e komponentëve të tij pranë SHUKALB-it, për të pasur situatë reale mbi UPA;

e) të organizojë task-forcën me ndihmën edhe të Bashkisë Bulqizë, për evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetin e shpërndarjes dhe të transmetimit;

f) të bashkëpunojë me OSHEE për verifikimin e numrin të lidhjeve për furnizimin me ujë, duke u bazuar në kontratat e lidhura prej saj;

g) të bëjë përpjekje për përthithjen e investimeve jo vetëm për rikonstruksionin e rrjetit ekzistues të dëmtuar por edhe për shtrimin e rrjeteve të reja të cilat do të mundësojnë rritjen e zonave të mbuluara me shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime;

h) të zbatojë normën e konsumit prej 150 litra/ditë/person ($4.5 \text{ m}^3/\text{ditë/person}$) për klientët familjarë aforfe sipas vendimit 102 datë 16.3.1992, “Për normat e përdorimit dhe çmimit të ujit të



pijshtëm në qytet dhe fshat” dhe sipas analizës dhe rregullimit të ERRU-së;

i) të vendosë prioritet pajisjen me matës të klientëve në zonat rurale të cilët faturohen aforfe, në mënyrë që të paguajnë sasinë e ujit që konsumojnë;

j) ERRU-ja vlerëson se numri aktual i punonjësve (të përhershëm dhe të nënkontraktuar) tejkalon nevojën reale për të punësuar, kështu që rekomandohet të reduktohet numri i punonjësve në nivele optimale, në mënyrë që në aplikimin e ardhshëm sipas Metodologjisë së Tarifave, këto kosto të quhen të justifikuar nga ERRU-ja;

k) të ketë nën monitorim të vazhdueshëm klientët që nuk paguajnë, të marrë masa për arkëtimin e faturave korrente dhe të prapambetura;

l) të krijojë dhe mirëmbajë sisteme të informacionit teknik dhe financiar në përputhje me metodologjinë e vendosjes së tarifave që të mundësohet verifikimi i të dhënave;

m) UK Bulqizë të mbajë sistemet e informacionit për asetet me të gjitha të dhënat për ta, të hartojë planin e menaxhimit të aseteve dhe të mbajë në sistemet e kontabilitetit koston e amortizimit të aseteve;

n) të vijojë me investimet e planifikuara, duke shtrirë shërbimin e kanalizimeve në zonën që operon dhe duke eliminuar rrjetin e amortizuar nëpërmjet të cilit operon;

o) të faturojë për shërbimin KUN të gjithë klientët të cilët mbulohen me shërbim.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifat e propozuara nga operatori mbi bazën e Metodologjisë të miratuar me vendim nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura”, si dhe akteve të tjera rregullatore që lidhen me të, arrin në konkluzionin se tarifat e propozuara sipas analizës së kryer janë të bazuara dhe në zbatim të kriterëve ligjore referuese lidhur me koston e pranueshme dhe të justifikuar, si dhe përballueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, për gjithë sa më sipër, në zbatim të neneve 13, 14 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Bulqizë si më poshtë:

Tabela 3. Tarifat e miratuara nga ERRU-ja për shoqërinë UK Bulqizë

Kategoria	Tarifat sipas vendimit në zonën e shërbimit
Tarifë volumetrike për furnizimin me ujë	Lek/m³
Klientë familjarë	25
Klientë publikë	75
Klientë publikë (spitale)	55
Klientë privatë	83.3
Tarifë volumetrike për KUN	Lek/m³
Klientë familjarë	10
Klientë publikë	17
Klientë privatë	17
Tarifë fikse	Lek/muaj/lidhje
Konsumatorë familjarë	100
Konsumatorë publikë	100
Konsumatorë privatë	100

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2023 për UK Bulqizë do të jenë:



Tabela 4. Objektivat e treguesve të performancës për vitin 2023 sipas ERRU-së

Treguesit e performancës	Njësia e matjes	Niveli i objektivit për vitin 2023 të përcaktuar nga KKRR-ja
1. Uji pa të ardhura	%	40
2. Mbulimi me ujë*	%	69
3. Mbulimi me KUN*	%	26.8
4. Niveli i matjes	%	70.5
5. Norma e arkëtimit korrent	%	83.4
6. Norma e arkëtimit të përgjithshëm	%	93
7. Vazhdimësia e furnizimit me ujë	orë/ditë	14
8. Efienca e stafit	staf/1000 lidhje UK	5.9
9. Mbulimi i kostove O&M	%	113
10. Mbulimi i kostove totale	%	100

*Mbulimi me shërbim FU dhe KUN është rивerësuar duke marrë për bazë popullsinë sipas Censurit

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjetllës-Kanalizime Bulqizë sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Lidhjen e kontratës me UK Bulqizë brenda 30 ditëve nga data e njoftimit sipas pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 8102.

5. Shfuqizohet vendimi i KKRR-së nr. 25, datë 17.10.2012, “Për miratimin e tarifave dhe objektivave të performancës për sh.a. U Bulqizë”.

6. Ky vendim hyn në fuqi me datë 1.10.2022 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM Nr. 382, datë 31.8.2022

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË UJËSJELLËS-KANALIZIME KUKËS SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 39), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit

mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 40), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 31.8.2022 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjetllës-Kanalizime Kukës sh.a. për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime, me anë të shkresës nr. 491 prot, datë 19.10.2021, me lëndë “Kërkesë për nivel të ri tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura”, të paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për ndryshimin e tarifave në zonën e shërbimit për të tri kategoritë e konsumatorëve, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe vendimin nr. 40 të KKRR-së,

VËREN SE:

1. Paraqitja e kërkesës për nivel të ri të tarifave volumetrike dhe fikse të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura të shoqërisë UK Kukës, është në përputhje me përcaktimet dhe



procedurën e parashikuar në vendimin nr. 40, prandaj me vendimin nr. 537, datë 30.12.2021 vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për propozimin e bërë nga UK Kukës për nivel të ri tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura për të gjithë zonën e riorganizuar të shërbimit në zbatim të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

2. Ujësjellës-Kanalizime Kukës në dokumentacionin e paraqitur pranë ERRU-së, me shkresë nr. 491 prot., datë 19.10.2021 “Kërkesë për nivel të ri tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura” propozon nivel të ri për tarifën volumetrike për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për secilën zonë për të tria kategoritë e konsumatorëve, si dhe vendosjen e tarifave fikse sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 1. Tarifat aktuale e të propozuara nga shoqëria sipas kategorisë së konsumatorëve

Kategoria e klientëve	Zona e shërbimit		
	Tarifat aktuale	Tarifat e propozuara	Ndryshimi
A. Shërbimi i FU	Lekë/m³	Lekë /m³	Lekë /m³
1. Klientë familjarë	25	40	+15
2. Klientë publikë	60	115	+55
3. Klientë privatë	80	120	+40
B. Shërbimi i KUN	Lekë/m³	Lekë/m³	Lekë/m³
1. Klientë familjarë	7	10	+3
2. Klientë publikë	15	30	+15
3. Klientë privatë	20	40	+20
C. Tarifë fikse shërbimi	Lekë/muaj/lidhje	Lekë/muaj/lidhje	Lekë /muaj/lidhje
1. Klientë familjarë	0	50	+50
2. Klientë publikë	0	100	+100
3. Klientë privatë	0	150	+150

3. Shoqëria UK Kukës ofron shërbimin e furnizimit me ujë me treguesit e performancës, përkatësisht: mbulimi me shërbime të FU në nivelin 60.4% të popullsisë në zonën e juridiksionit të saj, uji pa të ardhura në nivelin 56.5%, norma korrente e arkëtimit në 47%, operon me 6.62 staf/1000 lidhje UK dhe me të ardhurat e gjeneruara mbulon 100.3% kostot e O&M.

4. Në aplikimin e shoqërisë me referencë vitin e mbyllur 2020, si dhe duke konsideruar tarifën e propozuar, shoqëria ka përcaktuar objektivat që do realizohen në vitin 2022. Treguesit kryesorë të performancës për të dy vjetët, përkatësisht 2020–2021, si edhe objektivat për vitin 2022, jepen në tabelën e mëposhtme.

Tabela 2. Treguesit kryesorë të performancës sipas shoqërisë për vitet 2020–2021–2022

Treguesit e performancës	Njësia	Treguesit e performancës sipas shoqërisë		
		Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022 Parashikimi
1. Uji pa të ardhura	%	56.5	54.5	53.7
2. Mbulimi me ujë	%	60.4	60.7	63.3
3. Mbulimi me KUN	%	39.9	39.9	39.9
4. Niveli i matjes	%	37.8	37.8	52.2
5. Norma e arkëtimit korrente	%	47	47.2	71.3
6. Norma e arkëtimit e përgjithshme	%	76	72	86
7. Vazhdimësia e furnizimit me ujë	orë/ditë	8.4	10.2	12
8. Eficienca e stafit	staf/1000 lidhje UK	6.62	7.71	7.57
9. Mbulimi i kostove O&M	%	100.3	79.5	128.6
10. Mbulimi i kostove totale	%	60.4	55.1	92.6



5. Shoqëria në relacionin e saj e justifikon nevojën e ndryshimit të tarifave sipas argumenteve të mëposhtme:

a) për arsye të riorganizimit në zbatim të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”;

b) aplikon për tarifa FU dhe KUN pranë ERRU-së pasi tarifave aktuale u ka mbaruar afati;

c) aplikon për vendosjen e tarifës fikse dhe për rritje të tarifave variabël për shkak të nevojës për të ardhura dhe krijimin gradual të qëndrueshmërisë financiare.

6. Gjatë procesit të analizës teknike ekonomike sipas metodologjisë së llogaritjes së tarifave të përcaktuar në vendimin nr. 42, ERRU-ja ka kërkuar informacion shtesë nga UK Kukës, si dhe ka verifikuar nëpërmjet kontrollit në subjekt saktësinë e të dhënave të vëna në dispozicion nga Shoqëria.

7. Në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe treguesve të performancës, si dhe në analizën ekonomike financiare, janë marrë në konsideratë përmbushja nga UK Kukës e kriterëve të mëposhtme:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes nëpërmjet vendosjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të shitjes apo e kushteve të tjera të tregut;

c) kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar;

d) orientimit drejt mbulimit të kostove të justifikuara të operimit dhe të mirëmbajtjes;

e) orientimit të tarifave të secilit shërbim FU dhe KUN drejt kostove të secilit shërbim FU dhe KUN;

f) tarifat e propozuara nga operatori të jenë në përputhje të plotë me parimin ligjor rregullator mbi **përballueshmërinë** e tyre nga ana e konsumatorëve familjarë;

g) tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e

operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen;

h) propozimin për tarifa nga shoqëria, ERRU nuk e konsideron në përputhje me metodologjinë për shkak të rritjes së menjëhershme të tarifave volumetrike, referuar kjo analizës tekniko-ekonomike, si dhe realizimit të objektivave të performancës të përcaktuara.

8. Në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë konsiderohen të arritshëm objektivat mbi treguesit e performancës të vendosura nga ERRU-ja dhe për këtë kjo e fundit ka vendosur për shoqërinë UK Kukës detyrat si më poshtë:

a) të kryejë vlerësimin e “Ujit të prodhuar” bazuar në regjistrimet ditore të prodhimit, në çdo pike ku ai përftohet, për sa kohë që asnjë nga burimet, S/P dhe depot nuk kanë të instaluar ujëmatës, vlerësimi i prodhimit do të bëhet me metoda alternative inxhinierike të thjeshta;

b) duke pasur parasysh problematikën në hartimin e bilancit të ujit, në kuadër të programeve të trajnimit nga SHUKALB-ja të trajnojë stafin profesionist mbi njohjen, hartimin e bilancit të ujit dhe përlllogaritjen e komponentëve të tij, për një vlerësim real të UPA (humbjeve).

c) të realizojë reduktimin e nivelit të treguesit UPA duke u fokusuar në aksionin për gjetjen dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme kryesisht në rrjetin e shpërndarjes, si dhe në sigurimin dhe përdorimin me efikasitet të investimeve për uljen e humbjeve fizike (sidomos në tubacionet ku ka çarje të shpeshta), në transmetim dhe shpërndarje.

d) të vendosë prioritet pajisjen me matës të klientëve familjarë dhe jofamiljarë të cilët faturohen aforfe, në mënyrë që të paguajnë sasinë e ujit që konsumojnë.

e) të zbatojë normën e konsumit prej 150 litra/ditë/person ($4.5 \text{ m}^3/\text{ditë/person}$) për klientët familjarë aforfe sipas vendimit 102, datë 16.3.1992 “Për normat e përdorimit dhe çmimit të ujit të pijshëm në qytet dhe fshat” dhe sipas analizës dhe rregullimit të ERRU-së.

f) të marrë masa si monitorim, ndërprerje të shërbimeve të klientëve që nuk paguajnë, gjithashtu shtim të qendrave ku paguhen faturat, pagesa bankare, apo pagesa on-line për përmirësimin e treguesit norma korrente e arkëtimit;

g) të jepen të argumentuara të gjitha pozicionet e punës për të gjithë punonjësit në listëpagesë dhe



të merret në konsideratë mundësia e reduktimit të punonjësve në pozicionin manovrator, në mënyrë që të përmirësohet efienca e stafit dhe rrjedhimisht të ulen edhe kostot e punës;

h) të krijojë dhe mirëmbajë sisteme të informacionit teknik dhe financiar në përputhje me metodologjinë e vendosjes së tarifave që të mundësohet verifikimi i të dhënave;

i) pas përmbushjes së të gjitha rekomandimeve dhe treguesve të performancës të caktuara nga ERRU-ja të riaplikojë për nivel tarifor në vitin 2024 me qëllim 100% mbulimin e kostove totale, duke i dhënë prioritet tarifës fikse pasi UK Kukës ka një numër të konsiderueshëm të klientëve inaktivë.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifat e propozuara nga operatori mbi bazën e Metodologjisë, të miratuar me vendim nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura”,

si dhe akteve të tjera rregullatore që lidhen me të, arrin në konkluzionin se tarifat e propozuara sipas analizës së kryer janë të bazuara dhe në zbatim të kriterëve ligjore referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuara si dhe përballueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, për gjithë sa më sipër, në zbatim të neneve 13, 14 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Kukës si më poshtë:

Tabela 3. Tarifat e miratuara nga ERRU për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Kukës

Kategoria e klientëve	Njësia	Tarifat sipas vendimit
A. Shërbimi i furnizimit me ujë		
1. Klientë familjarë	Lek/m ³	30
2. Klientë publikë	Lek/m ³	80
3. Klientë privatë	Lek/m ³	100
B. Shërbimi i largimit të ujërave të ndotura		
1. Klientë familjarë	Lek/m ³	10
2. Klientë publikë	Lek/m ³	20
3. Klientë privatë	Lek/m ³	30
C. Tarifë fikse shërbimi		
1. Klientë familjarë	Lek/muaj/lidhje	50
2. Klientë publikë	Lek/muaj/lidhje	100
3. Klientë privatë	Lek/muaj/lidhje	100

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2023 për UK Kukës do të jenë:

Tabela 4. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2023 për UK Kukës

Treguesit e performancës	Njësia e matjes	Objektivat për vitin 2023 të përcaktuar nga ERRU-ja
1. Uji pa të ardhura	%	48.9
2. Mbulimi me ujë	%	63.3
3. Mbulimi me KUN	%	39.9
4. Niveli i matjes	%	52.2
5. Norma e arkëtimit korrente	%	71.3
6. Norma e arkëtimit të përgjithshme	%	86
7. Vazhdimësia e furnizimit me ujë	orë/ditë	12



8. Eficienca e stafit	staf/1000 lidhje UK	7.57
9. Mbulimi i kostove O&M	%	120.9
10. Mbulimi i kostove totale	%	84

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Kukës sh. a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Lidhjen e kontratës me UK Kukës brenda 30 ditëve nga data e njoftimit sipas pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 8102.

5. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.10.2022 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 383, datë 31.8.2022

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË
SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË
PËR SHOQËRINË UJËSJIJLLËS-
KANALIZIME KONISPOL SHA**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 39), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 40), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

Në mbledhjen e datës 31.8.2022 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e UK Konispol sh.a. për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë, me anë të shkresë nr. 123 prot, datë 14.12.2021, me lëndë “Lista e dokumentacionit të nevojshëm për unifikimin e tarifave të ujit për UK Konispol”, të paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për ndryshimin e tarifave në zonën e shërbimit për të tria kategoritë e konsumatorëve, si dhe për ujin me shumicë, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe vendimin nr. 40 të KKRR-së,

VËREN SE:

1. Paraqitja e kërkesës për ligjërimin e tarifave volumetrike të shërbimit të furnizimit me ujë të shoqërisë UK Konispol, është në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin nr. 40, prandaj me vendimin 536 datë 30.12.2021 vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për propozimin e bërë nga UK Konispol për nivel të ri tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm për të gjithë zonën e riorganizuar të shërbimit në zbatim të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

2. Ujësjiellës-Kanalizime Konispol në dokumentacionin e paraqitur pranë ERRU-së, me shkresë nr. 123 prot, datë 14.12.2021 “Kërkesë për miratimin e tarifave të ujit për shërbimin e furnizimit me ujë” propozon të ligjërojë tarifat volumetrike për shërbimin e furnizimit me ujë për secilën zonë për të tre kategoritë e konsumatorëve, sipas tabelës së mëposhtme:



Tabela 1. Tarifat aktuale e të propozuara nga shoqëria sipas kategorisë së konsumatorëve

Kategoria e klientëve	Tarifat aktuale*		Tarifat e propozuara		Ndryshimi	
	Zona e shërbimit		Zona e shërbimit		Zona e shërbimit	
	Konispol, Mursi, Vrine, Shëndëlli, Verve, Dishat, Markat, Ninat	Ciflik, Shkallë, Xarre, Shales	Konispol, Mursi, Vrine, Shëndëlli, Verve, Dishat, Markat, Ninat	Ciflik, Shkallë, Xarre, Shales	Konispol, Mursi, Vrine, Shëndëlli, Verve, Dishat, Markat, Ninat	Ciflik, Shkallë, Xarre, Shales
A. Shërbimi i FU	Lek/m ³	Lek/	Lek/m ³	Lek/	Lek/m ³	Lek/m ³
1. Klientë familjarë	66.7	50	66.7	50	0	0
2. Klientë publikë	83.3	83.3	83.3	83.3	0	0
3. Klientë privatë	83.3	83.3	83.3	83.3	0	0

3. Shoqëria UK Konispol ofron shërbimin e furnizimit me ujë me treguesit e performancës, përkatësisht: mbulimi me shërbime të FU në nivelin 94.9% të popullsisë në zonën e juridiksionit të saj, uji pa të ardhura në nivelin 35.02%, norma korrente e arkëtimit në 98.5%, operon me 10.9 staf/1000 lidhje UK dhe me të ardhurat e gjeneruara mbulon 59 % kostot e O&M.

4. Në aplikimin e shoqërisë me referencë vitin e mbyllur 2020, si dhe duke konsideruar tarifat e propozuara, shoqëria ka përcaktuar objektivat që do realizohen në vitin e 2022. Treguesit kryesorë të performancës për të dy vjetët, përkatësisht 2020–2021, si edhe objektivat për vitin 2022, jepen në tabelën e mëposhtme.

Tabela 2. Treguesit kryesorë të performancës sipas shoqërisë për vitet 2020–2021–2022

Treguesit e performancës	Njësia	Treguesit e performancës sipas shoqërisë		
		Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022 Parashikimi
1. Uji pa të ardhura	%	35.02	24.4	3.7
2. Mbulimi me ujë	%	94.9	94.9	94.9
3. Niveli i matjes	%	100	100	100
4. Norma e arkëtimit korrente	%	98.5	93.2	95
5. Norma e arkëtimit të përgjithshëm	%	143.7	95	97.1
6. Vazhdimësia e furnizimit me ujë	orë/ditë	24	24	24
7. Eficienca e stafit	staf/1000 lidhje UK	10.9	10.5	10.4
8. Mbulimi i kostove O&M	%	59	67.3	73.6
9. Mbulimi i kostove totale		59	67.3	73.6

5. Shoqëria në relacionin e saj e justifikon nevojën e ndryshimit të tarifave sipas argumenteve të mëposhtme:

a) për arsye të riorganizimit në zbatim të VKM nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”;

b) aplikon për herë të parë për tarifa FU pranë ERRU-së pas licencimit dhe kërkon të ligjërojë tarifat që aktualisht aplikon;

c) të krijohet gradualisht qëndrueshmëria financiare për shoqërinë pasi të ardhurat aktuale

nga tarifat arrijnë të mbulojnë vetëm 59% të kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes.

6. Gjatë procesit të analizës teknike ekonomike sipas metodologjisë së llogaritjes së tarifave të përcaktuar në vendimin nr. 42, ERRU-ja ka kërkuar informacion shtesë nga UK Konispol, si dhe ka verifikuar nëpërmjet kontrollit në subjekt, **saktësinë e të dhënave të vëna në dispozicion nga Shoqëria.**

7. Në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe treguesve të performancës, si dhe në analizën ekonomike financiare, janë marrë në konsideratë përmbushja nga UK Konispol e kriterëve të mëposhtme:



a) kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes nëpërmjet vendosjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të shitjes apo e kushteve të tjera të tregtimit;

c) kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar;

d) orientimin drejt mbulimit të kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes;

e) tarifat e propozuara nga operatori të jenë në përputhje të plotë me parimin ligjor rregullator mbi **përballueshmërinë** e tyre nga ana e konsumatorëve familjarë;

f) tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen;

g) propozimin për tarifa nga shoqëria, ERRU-ja e gjen të justifikuar, në nivelin e propozuar nga shoqëria, referuar kjo analizës tekniko ekonomike si dhe realizimit të objektivave të performancës të përcaktuara.

8. Në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë konsiderohen të arritshëm objektivat e vendosur mbi treguesit e performancës nga ERRU-ja dhe për këtë janë lënë detyra për shoqërinë UK Konispol si më poshtë:

a) të kryejë vlerësimin e “Ujit të prodhuar” bazuar në regjistrimet ditore të prodhimit, në çdo pikë ku ai përftohet. Për sa kohë që asnjë nga burimet, S/P dhe depot nuk kanë të instaluar ujëmatës vlerësimit i prodhimit do të bëhet metoda alternative inxhinierike të thjeshta;

b) duke pasur parasysh problematikën në hartimin e bilancit të ujit, në kuadër të programeve të trajnimit nga SHUKALB (Shoqata e Shoqërive Ujësjellës-Kanalizime në Shqipëri) të trajnojë stafin profesionist mbi njohjen, hartimin e Bilancit të Ujit dhe përlllogaritjen e komponentëve të tij, për një vlerësim real të UPA (humbjeve);

c) të organizojë task-forcën me ndihmën edhe të Bashkisë Konispol, për evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetin e shpërndarjes;

d) të rivlerësojë popullsinë e shërbyer duke u bazuar në llogaritjet me mesataren 3.3 persona për një lidhje të FU. Në rast të mbajtjes së këtij treguesi të pandryshuar nga ai i paraqitur në këtë aplikim të vërtetohet në mënyrë të dokumentuar bazën e llogaritjes me 6 persona për një lidhje. Vlerësimi do të shërbejë për përcaktimin e saktë të familjeve të cilat nuk kanë kontratë me U Konispol;

e) të analizojë vlerat e pasqyruara në llogaritë e arkëtueshme të klientëve dhe të ndajë llogaritë e arkëtueshme të klientëve nga taksat e bashkisë;

f) të analizojë vlerat e pasqyruara në llogaritë e pagueshme dhe të kryejë sistemimet për fshirjen e detyrimeve të rekomanduara edhe nga audituesi, si dhe të kryejë rakordimet me OSHEE-në;

g) t'i kushtojë vëmendje të veçantë komponentit të konsumit të energjisë elektrike në leximet e sakta të konsumit në kontatorin e OSHEE-së për të eliminuar problemet e pasaktësisë së konsumit të energjisë elektrike në stacione e pompimit dhe pusët;

h) të llogarisë amortizimin vjetor me normat e caktuara nga ERRU-ja dhe ta paraqesë atë çdo vit në raportimin e të dhënave pranë ERRU-së;

i) të hartojë dosjet përkatëse të informacionit teknik mbi sistemet e furnizimit me ujë dhe komponentët e tij në përputhje me formatin e kërkuar nga ERRU-ja dhe t'i dorëzojë ato para aplikimit të radhës për tarifa të reja pranë ERRU-së;

j) të krijojë dhe mirëmbajë sisteme të informacionit teknik dhe financiar në përputhje me metodologjinë e vendosjes së tarifave që të mundësohet verifikimi i të dhënave.

Në këtë kuadër shoqëria duhet të saktësojë të dhënat të cilat japin rezultate paradoksale të TKP, si nga njëra anë, konstatohet ulja e normës korrente të faturimit dhe nga ana tjetër jepet përmirësim i treguesit të mbulimit të kostove të O&M. Kjo mund të ndodhe vetëm në rastet kur kemi ulje të konsiderueshme të kostove dhe/ose rritje të konsiderueshme të faturimeve, gjë e cila duhet të demonstron me të dhëna të plota dhe të sakta që përbejnë këta tregues të performancës;

k) të realizojë reduktimin e nivelit të treguesit UPA duke u fokusuar në aksionin për gjetjen dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme kryesisht në rrjetin e shpërndarjes, si dhe në sigurimin dhe përdorimin me efikasitet të investimeve për uljen e humbjeve fizike, në transmetim dhe shpërndarje.



l) të vendosen matësit në të gjitha stacionet e pompimit, në mënyrë që uji i prodhuar të matet me saktësi;

m) pas përmbushjes së të gjitha detyrave dhe treguesve të performancës të caktuara nga ERRU-ja, shoqëria duhet të ndërmarrë hapat e nevojshme institucionale që të përfshijë në aktivitetin e saj edhe shërbimet e kanalizimeve të ujërave të ndotura, që aktualisht administrohen nga Bashkia Konispol. Kjo do t'i shërbejë rritjes së cilësisë së shërbimeve për konsumatorin, si edhe përmirësimit të performancës financiare të shoqërisë.

n) Për rritjen e performancës financiare është e domosdoshme që shoqëria U Konispol të ri aplikojë për tarifa të reja për vitin 2024. Duke pasur parasysh natyrën e zonës urbane të Konispolit shoqëria U Konispol kur do të aplikojë për tarifa të reja duhet të përfshijë në strukturën e tarifave të reja edhe tarifën fikse, e cila mungon aktualisht. Kjo mundëson respektimin e kriterit për të mos aplikuar një rritje të menjëhershme të tarifës volumetrike, si edhe i jep më shumë garanci përmirësimit të performancës financiare të shoqërisë nga luhajtja e prezencës së konsumatorëve gjatë vitit.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifat e propozuara nga operatori mbi bazën e Metodologjisë të miratuar me vendim nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura”, si dhe akteve të tjera rregullatore që lidhen me të, arrin në konkluzionin se tarifat e propozuara sipas analizës së kryer janë të bazuara dhe në zbatim të kriterëve ligjore referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuara, si dhe përbalueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, për gjithë sa më sipër, në zbatim të neneve 13, 14 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjetës-Kanalizime Konispol si më poshtë:

Tabela 3. Tarifat e miratuara nga ERRU për shoqërinë UK Konispol

Kategoria	Tarifat në zonën e shërbimit sipas vendimit	
	Konsipol, Mursi, Vrine, Shëndëlli, Verve, Dishat, Markat, Ninat	Ciflik, Shkallë, Xarrë, Shales
Tarifë volumetrike për furnizimin me ujë	Lek/m³	Lek/m³
Klientë familjarë	66.7	50
Klientë publikë	83.3	
Klientë privatë	83.3	

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2023 për UK Konispol, do të jenë:

Tabela 4. Objektivat e treguesve të performancës për vitin 2023 sipas ERRU-së

Treguesit e performancës	Njësia e matjes	Niveli i objektivit për vitin 2023 të përcaktuar nga ERRU-ja
1. Uji pa të ardhura	%	30.3
2. Mbulimi me ujë	%	92.2
3. Niveli i matjes	%	100
4. Norma e arkëtimit korrent	%	95
5. Norma e arkëtimit të përgjithshëm	%	97
6. Vazhdimësia e furnizimit me ujë	orë/ditë	24
7. Eficienca e stafit	staf/1000 lidhje UK	10.4
8. Mbulimi i kostove O&M	%	56.4



3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Konispol sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Lidhjen e kontratës me UK Konispol brenda 30 ditëve nga data e njoftimit sipas pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 8102.

5. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.10.2022 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

KËRKESË

Shtetasja Pranvera Mihaj kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, shpalljen e vdekjes së xhaxhait të saj, shtetasit Ferdinand Mihaj.

KËRKUESE
Pranvera Mihaj

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë